



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 631/6 Prot

Tiranë, më 22.09.2021

**V E N D I M**

Nr. 114, datë 22.09.2021

**Mbi përfundimin e hetimit administrativ me objekt vlerësimin e ligjshmërisë së aktit nr. 622 (14069 prot.), datë 18.11.2020, të drejtuesit të Bashkisë Durrës, për transferimin e përkohshëm të nëpunëses \*\*\*\*\* dhe veprimet që duhen kryer për rregullimin e gjendjes së ligjshmërisë.**

Në mbështetje të kompetencave të parashikuara në pikën 1, të nenit 11, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, të nenit 95, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit, pas shqyrtimit të materialit të përgatitur dhe propozimit të paraqitur prej Drejtorisë së Përgjithshme të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes, në lidhje me vlerësimin e ligjshmërisë të aktit për transferim të përkohshëm të nëpunëses \*\*\*\*\*,

**VËREJ SE:**

Nëpërmjet kërkesës, protokolluar me nr. 631 prot, datë 26.5.2021, paraqitur nga nëpunësja e Bashkisë Durrës, \*\*\*\*\* , është ngritur pretendimi se në kundërshtim me rregullat e legjislacionit të shërbimit civil, pas përfundimit të afatit 6-mujor të transferimit të përkohshëm, nuk është kthyer në pozicionin e mëparshëm si “Drejtor i Drejtorisë të Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit”, të kësaj bashkie.

Për efekt të vlerësimit të ligjshmërisë së veprimeve administrative të kryera në këtë rast dhe për të qartësuar pretendimet mbi problematikën e paraqitur, bazuar në nenin 16, kreu III, “Procedura paraprake”, të Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar

me vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, është kryer verifikimi paraprak i informacionit të dërguar nga punonjësja \*\*\*\*\*.

Nga dokumentacioni i administruar rezultoi e vërtetuar se, punonjësja në fjalë pas kryerjes së procedurës së konkurrimit për lëvizje paralele, të parashikuar nga neni 26, i ligjit nr.152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar dhe kreu II, i vendimit nr. 242, datë 18.3.2015, të Këshillit të Ministrave, *“Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese”*, i ndryshuar, është emëruar nëpunës civil në pozicionin *“Drejtor në Drejtorinë e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit”*, në administratën e Bashkisë Durrës.

Më pas, në interes të institucionit, me aktin me nr. 622 (14069 prot.), datë 18.11.2020, të drejtuesit të Bashkisë, ajo është transferuar përkohësisht, në detyrën *“Drejtor në Drejtorinë e Turizmit, Politikave të Zhvillimit dhe Integritimit Europian”*, brenda institucionit të Bashkisë Durrës.

Ky urdhër është zbatuar pa kushte nga ana e nëpunëses, por pas kalimit të afatit 6 mujor të transferimit të përkohshëm, në kundërshtim me përcaktimin e pikës 4, të nenit 48, të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar dhe moskthimit të saj në pozicionin e mëparshëm, ajo ka filluar të kërkojë zbatimin e ligjit. Në kushtet e mosveprimit nga ana e bashkisë, ajo ka kërkuar ndërhyrjen e Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për rivendosjen e të drejtës së saj.

Konstatohet që, pas fillimit të verifikimit të rastit nga ana e Komisionerit, njësia përgjegjëse e Bashkisë Durrës, njofton se me aktin nr. 86 (8094 prot.) datë 7.7.2021, është urdhëruar kthimi i nëpunëses \*\*\*\*\* në pozicionin ku ajo ka emërimin e rregullt *“Drejtor në Drejtorinë e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit”*, (Shih shkresën nr. 5905/5 prot., datë 12.7.2021, *“Kthim përgjigje suajës nr. 631/2, datë 8.6.2021”*, dërguar Komisionerit, nga Bashkia Durrës).

Me kryerjen e veprimit të mësipërm, shkak i mosmarrëveshjes ka rënë, duke e bërë të panevojshëm vijimin e këtij hetimi administrativ, por sidoqoftë, sjellim në vëmendje të njësisë përgjegjëse të Bashkisë Durrës, që në të ardhmen, të tregojë më tepër kujdes në zbatimin e gjithë kërkesave të legjislacionit të shërbimit civil, duke përfshirë edhe respektimin e afateve të përcaktuara nga ligji, për raste të ndryshme.

### **Për këto arsye:**

Në mbështetje të kompetencës së përcaktuar në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, në nenin 95, të ligjit nr. 44/2015, *“Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”*, i cili parashikon, përfundimin e procedurës administrative, kur objekti për të cilin ka nisur procedura është realizuar, si dhe në mbështetje të nenit 16, pika 6, të Rregullores, *“Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”*,

miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

**VENDOSA:**

1. Përfundimin e hetimit administrativ filluar në bazë të kërkesës nr. 631 prot, datë 26.5.2021, të nëpunëses \*\*\*\*\* , në lidhje me pretendimet për parregullsi ligjore në kryerjen e transferimit të saj të përkohshëm dhe arkivimin e çështjes, duke i vënë në dukje njësisë së burimeve njerëzore të institucionit, të respektojë parimet dhe afatet e legjislacionit të shërbimit civil, siç është shprehur pjesa arsyetuese e këtij vendimi.
2. Të njoftohet për këtë vendim Bashkia Durrës, Njësia Përgjegjëse dhe nëpunësja \*\*\*\*\*.

**KOMISIONERI**

**Pranvera Strakosha**